REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT
TIRANE

Nr.4358/1685 Regjistri Themeltar **Nr.1641 Vendimi**

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Apelit Tirane e perbere nga:

KRYESUES	**: HYSNI**	**DEMIRAJ**
ANETAR	**: GJIN**	**GJONI**
ANETAR	**: RIDVAN**	**HADO**

Asistuar nga sekretarja gjyqesore **Dafina Morina** sot, ne date **28.06.2017** mori ne shqyrtim ne shkalle te dyte çeshtjen civile,

PADITËS: 1. **Vjollca Hoxha**, e bija e Shaqirit dhe Miles, datëlindja 23.03.1969, lindur dhe banuese në Tiranë, Adresa: Bulevardi "Bajram Curri", Pallati ETC, Tiranë.

2. **Lorela Hoxha**, e bija e Dritanit dhe Vjollcës, datëlindja 19.10.1993, lindur dhe banuese në Tiranë, Adresa: Bulevardi "Bajram Curri", Pallati ETC, Tiranë.*ne mungese.*

3. **Sara Hoxha, e** bija e Dritanit dhe Vjollcës, datëlindja 18.01.1996, lindur dhe banuese në Tiranë, Adresa: Bulevardi "Bajram Curri", Pallati ETC, Tiranë. *ne mungese.*

4. **Redia Hoxha**, e bija e Dritanit dhe Vjollcës, datëlindja 15.02.1998, lindur dhe banuese në Tiranë, Adresa: Bulevardi "Bajram Curri", Pallati ETC, Tiranë. *ne mungese.*

5. **Itan Hoxha**, i biri i Dritanit dhe Vjollcës, datëlindja 04.07.2007, lindur ne Romë, Itali dhe banues në Tiranë, Adresa: Bulevardi

"Bajram Curri", Pallati ETC, Tiranë, me përfaqësim ligjor nga e ëma e tij Vjollca Hoxha.

Të përfaqësuar nga Av.Envi Hicka, me liçense Nr.1776, dhe Av.Artan Hajdari, me liçense Nr.745, zgjedhur me prokurën e posaçme Nr.245Rep., dhe Nr.56Kol., datë 19.01.2016.

PADITUR: 1.**Albert Sino,** i biri i Yllit dhe Rakipe, datëlindja 31.11.1975, lindur dhe banues Tiranë, Adresa: Rruga "Mati Logoreci", Tiranë, përfaqësuar nga Av.Marsela Kokoshi ne mungese.

2. **Aurel Baçi**, i biri i Nevriz dhe Refie, datëlindja 04.09.1967, lindur dhe banues Tiranë, Adresa: Rruga "Rexhep Preza", Nr.7, Tiranë, përfaqësuar nga Av.Genc Çifligu, me liçense Nr.2589, dhe Av.Arjan Salati, me liçense Nr.2590, zgjedhur me prokurën Nr.782Rep., Nr.448Kol., datë 16.02.2016.

OBJEKTI: Detyrimi i të paditurve të njohin paditësit pronarë edhe mbi 60% të aksioneve të Shoqerisë "Top Channel" sha, NIPTI K12007002U, shoqëri e së drejtës shqiptare, për shkak se Kontrata e Shitblerjes së Aksioneve me Nr.1154Rep. dhe Nr.598/2Kol., datë 15.06.2007, e lidhur përpara noterit Artan Treska, është absolutisht e pavlefshme, pasi është kryer në kundershtim me ligjin.

Urdhërimin e ç'rregjistrimit nga regjistri i aksionarëve të Shoqerisë "Top Channel" sh.a të të paditurve Albert Sino dhe Aurel Baçi dhe nga regjistri i ekstraktit të Shoqerisë në QKR, pasi titulli në bazë të të cilit është bërë regjistrimi i tyre në regjistër, është i pavlefshëm.

BAZA LIGJORE:Neni 92 dhe nenet 199 e në vijim te Kodit Civil. Neni 208 të Kodit Civil. Kodi Familjes së R.Sh. Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare". Nenet 202 e vijues të Kodit te Procedurës Civile si dhe nenet 154 e vijues te këtij Kodi.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane me vendimin civil nr.3873 date 09.05.2016 ka vendosur:

-Rrëzimin e padisë së palëve paditëse Vjollca Hoxha, Lorela Hoxha, Sara Hoxha, Redia Hoxha dhe Itan Hoxha, si të pabazuar në ligj dhe në prova.

-Heqjen e masës së sigurimit të padisë të vendosur me vendimin Nr.5059 akti, datë 05.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

-Garancia e dhënë sipas nenit 202 të Kodit te Procedures Civile, me vendimin Nr.5059 akti, datë 05.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i kthehet palëve paditëse, në rast se palët e paditura brenda pesëmbëdhjetë ditëve, pasi vendimi të ketë marrë formën e prerë, nuk do të paraqesë padinë për shpërblimin e dëmit të ardhur për një shkak të tillë.

Kundër këtij vendimi, ka ushtruar kërkesë ankimore palet paditese,duke ngritur keto pretendime ne lidhje me vendimin e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Gjate kohezgjatjes se marteses se paditeses Vjollca Hoxha me te ndjerin Dritan Hoxha ne bashkesine ligjore jane fituar disa pasuri te luajtshme e te paluajtshme , nder te tjera ne bashkepronesine ligjore eshte dhe Shoqeria Top-Chanel sh.a e cila e themeluar me nje ortak te vetem Z.Dritan Hoxha i cili zoteronte 100% te aksioneve. Por rezulton se i ndjeri gjate qenies gjalle me kontrate noteriale nr.1154 Rep dhe nr 598/2 Kol date 15.06.2007 ka tjetersuar 60% te aksioneve te zoteruara ne Shoqerine Top-Chanel sh.a tek padituri Albert Sino 40% te aksioneve dhe Aurel Baci 20% te aksioneve. Nga raportet e mesiperme eshte bere tejtersimi i 60% te aksioneve pa marre pelqimin e bashkeshortes se tij.

Meqenese pjesa e secilit bashkeshort eshte percaktuar per te kryer keto veprime disponimi apo veprime qe tejkalojne veprimet e admsnistrimit te zakonshem dhe te perditeshem, mbi nje send apo te drejte qe perfshihet nen bashkesine ligjore duhet te ekzistoje pelqimi i njekoheshem i te dy bashekshorteve per aq kohe sa ne momentin se lidhjes se kontrates se shitbelerjeve se aksioneve nuk ishte bere pjestimi i bashkesise ligjore, e drejta e pronesise se cdo bashkeshorti mbi pasurine ne bashkesi ekziston si nje e tere.

Disponimi i sendeve në bashkësi ligjore mes bashkëshortëve nuk është i rregulluar drejtpërdrejt në mënyrë të shprehur në Kodin e Familjes. Meqenëse edhe veprimtaria tregtare përfshihet në pasurinë e përbashkët, duhet që sipas nenit 208 të Kodit Civil të japin pëlqimin të dy bashkëshortët, në përputhje edhe me nenin 90 të Kodit të Familjes. Neni 90 i Kodit te Famijes është një dispozitë urdhëruese e ligjit dhe mosrespektimi i saj sjell pavlefshmëri absolute të veprimit të disponimit të pasurisë.

Duhet të gjejë aplikim afati i parashkrimit të nenit 94 i Kodit te Familjes. Rreziku i keqkuptimit të kësaj dispozite është vërtetë aktual, por mendojmë se edhe nga leximi i kujdesshëm i saj, i orientuar nga konceptet e drejta të së drejtës civile mund të kuptohet se nuk ka arsye të gjejë zbatim në rastin konkret. Kryerja e veprimeve që kapërcejnë administrimin e zakonshëm u takon bashkërisht të dy bashkëshortëve. Në rradhë të parë ky nen bën fjalë për anullimin e veprimeve të bëra nga njëri prej bashkëshortëve. Termi anullim është i lidhur qartë me ato veprime që janë të anullueshme, pra veprimet juridike relativisht të pavlefshme. Përfundimisht, caktimi i një afati parashkrimi për ngritjen e kësaj padie, përjashton definitivisht mundësinë që të kemi të bëjmë me një veprim absoutisht të pavlefshëm, për shkak se kjo lloj pavlefshëmërie është e pashërueshme nga çdo afat kohor.

Tjetersimi i aksioneve të Shoqërisë "Top Channel" sh.a është kryer pa pëlqimin e të dy bashkëshortëve dhe për gjithë sa u tha më lart, ky veprim disponimi është nul dhe nuk ka prodhuar asnjë pasojë ligjore dhe për këtë shkak konsiderohet sikur nuk është kryer ndonjëherë dhe në përputhje me këtë, të drejtat e palëve quhet se nuk kanë ndryshuar ndonjëherë statusin juridik. Kjo do të thotë se kalimi i aksioneve nga i ndjeri Dritan Hoxha tek të padituri Albert Sino dhe Aurel Baçi, nuk është kryer asnjëherë.

Kontrata e shitjes se aksioneve si një veprim juridik fiktiv, si shkak i pavlefshmerise. Në fakt kontrata e lidhur mes Dritan Hoxhës dhe të padituve ka qenë një veprim fiktiv. Ajo është lidhur vetëm për të plotësuar për sy e faqe kriteret e nenit 20 të ligji Nr.9742, datë 08.05.2007, që kërkonte që asnjë subjekt në fushën e medias të mos zotërohej për më shumë se 40% nga një person i vetëm. Është për këtë shkak që Dritan Hoxha lidhi për sy e faqe një kontratë me dy të njohur të tij, siç ishin të padituri.

Vlerësimi i fiktivitetit të kësaj marrëveshje është shumë i thjeshtë, pasi ai lidhet me caktimin dhe pagimin e çmimit të kontratës. Çmimi për të padituri Albert Sino, për 40% të aksioneve, ishte 210,160,000 lekë dhe për të padituri Aurel Baçi, për 20% të aksioneve, ishte 105,080,000 lekë. Këto çmime thuhet në kontratë se janë paguar jashtë zyrës së noterit, ndërkohë që nuk rezulton asnjëherë kryerja e kësaj pagese. Këto çmime ishin jo vetëm të pamundur për t'u paguar nga të padituri, por edhe nëse do të ishin paguar ato nuk mund të vërtetohen me deftesë të thjeshtë, për shkak se në kuadër të ligjit, ato duhet të paguhen detyrimisht në rrugë formale bankare, për shkak të kufijve të caktuar me ligj. Kontrata e lidhur nuk mundet kurrsesi të zevendësojë apo të shëroje veset e pagesës informale, që nuk është kryer asnjëherë dhe që nuk ka patur qëllim të kryhej për shkak se palët kanë simuluar veprimin juridik.

Pronarë të aksioneve të Shoqërisë "Top Channel" sh.a duhet të njihen trashëgimtarët e shitësit, sikurse janë caktuar në dëshminë e trashëgimisë së

lëshuar për të ndjerin Dritan Hoxha, e konkretisht Vjollca Hoxha, Lorela Hoxha, Sara Hoxha, Redia Hoxha dhe Itan Hoxha. Duke qenë se paditësit e mësipërm, trashëgojnë të ndjerin Dritan Hoxha, në pjesë të barabarta, atëherë duhet të urdhërohet që secili prej paditësve të njihet si pronar i aksioneve të Shoqërisë "Top Channel" sh.a në masën 20% secili.

GJYKATA E APELIT TIRANË

Pasi dëgjoi relatimin e çeshtjes nga gjyqtari **Gjin Gjoni**, degjoi palen paditese av.Envi Hicka dhe Artan Hajdari qe kerkoj ndryshim te vendimit dhe pranimin e padise , palet e paditura me avokat Arjan Salati qe kerkoj lenie ne fuqi te vendimit, pala e paditur Albert Sino ne mungese, bisedoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Vendimi nr.3873 date 09.05.2016 i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane nuk eshte marre ne perputhje me ligjin prandaj duhet ndryshuar dhe padia duhet pranuar.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi e provuar se:

Pala paditëse Vjollca Hoxha dhe i ndjeri Dritan Hoxha kanë lidhur martesë ligjore më datë 17.08.1991. Palët e paditura Lorela Hoxha, Sara Hoxha, Redia Hoxha dhe Itan Hoxha, janë femijet e të ndjerit Dritan Hoxha. Shoqëria "Top Channel" Sha, është një person juridik i së drejtës shqiptare, fillimisht e regjistruar me vendimin Nr.25561, datë 29.03.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në formën e shoqërise tregtare me përgjegjësi të kufizuar me ortak të vetëm, të ndjerin Dritan Hoxha, si zotërues i 100% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Nga shqyrtimi i provave dhe akteve rezulton se me vendimin Nr.25561/6/7, datë 24.03.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur shndërrimi i Shoqërisë "Top Channel" Shpk, në shoqëri anonime dhe me objekt të ushtrimit të aktivitetit në fushën e veprimtarive televizive, prodhim, transmetim dhe ritransmetim i programeve, informacioneve, etj. Nga momenti i shndërrimit në shoqëri anonime dhe në vijim, 100% e aksioneve të Shoqërisë "Top Channel" sha, zotëroheshin nga i ndjeri Dritan Hoxha. Me kontratën e shitblerjes Nr.1154Rep., Nr.598Kol., datë 15.06.2007, i ndjeri Dritan Hoxha, në cilësinë e aksionerit të vetëm, ka disponuar shitjen e 40% të aksioneve të Shoqërisë "Top Channel" sha, tek blerësi, palë e paditur Albert Sino, si dhe shitjen e 20% të aksioneve tek blerësi tjetër, i padituri Aurel Baçi. Kontrata rezulton e depozituar në regjistrin tregtar me vendimin Nr.25561/8, date 15.06.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Referuar pretendimeve te paleve ne process por edhe provave te administruara rezulton se në datë 23.05.2008, rezultoi e provuar se ka ndërruar jetë i ndjeri Dritan Hoxha. Me vendimin Nr.5259, datë 06.06.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore të të ndjerit, duke caktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë bashkëshorten, paditësen Vjollca Hoxha, dhe fëmijët, paditesit e tjerë Lorela, Sara, Redia dhe Itan Hoxha.

Sipas akteve te administruar ne dosje më datë 18.01.2016, palët paditëse Vjollca Hoxha, Lorela Hoxha, Sara Hoxha, Redia Hoxha dhe Itan Hoxha, me cilësitë e bashkëshortes dhe trashëgimtarëve ligjore të të ndjerit Dritan Hoxha, dhe njëkohësisht në cilësinë e aksionerëve të shoqërisë "Top Channel" sha, i janë drejtuar Gjykatës me padinë objekt gjykimi.

Palët paditëse Vjollca Hoxha, Lorela Hoxha, Sara Hoxha, Redia Hoxha dhe Itan Hoxha pretendojnë se:

Paditësja Vjollca Hoxha ka lidhur martesë ligjore me të ndjerin Dritan Hoxha, më datë 17.08.1991. Gjatë kohëzgjatjes së martesës, ndër të tjera, në bashkësinë ligjore është përfshirë edhe pasuria e krijuar me krijimin e Shoqërisë tregtare "Top Channel" sh.p.k, sot "Top Channel" sh.a. Rezulton se gjatë kohës së qënies gjallë të bashkëshortit të paditëses, të ndjerit Dritan Hoxha, ky i fundit me kontratën noteriale me Nr.1154Rep., Nr.598/2Kol., datë 15.06.2007 ka tjetërsuar 60% të aksioneve të zotëruara në Shoqërinë Top Channel sh.a, tek të paditurit Albert Sino dhe Aurel Baçi, pa marrë pëlqimin e bashkëshortes së tij.

Pjesa e secilit bashkëshort është e papërcaktuar dhe për të kryer veprime disponimi apo veprime që tejkalojnë veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të përditshëm, mbi një send apo të drejtë, që përfshinet nën bashkësinë ligjore, duhet të ekzistojë pëlqimi i njëkohshëm i të dy bashkëshortëve.

Disponimi i sendeve në bashkësi ligjore mes bashkëshortëve nuk është i rregulluar drejtpërdrejt në mënyrë të shprehur në Kodin e Familjes. Meqenëse edhe veprimtaria tregtare përfshihet në pasurinë e përbashkët, duhet që sipas nenit 208 të Kodit Civil të japin pëlqimin të dy bashkëshortët, në përputhje edhe me nenin 90 të Kodit të Familjes. Neni 90 i Kodit te Famijes është një dispozitë urdhëruese e ligjit dhe mosrespektimi i saj sjell pavlefshmëri absolute të veprimit të disponimit të pasurisë.

Të vlerësojmë nëse duhet të gjejë aplikim afati i parashkrimit të nenit 94 i Kodit te Familjes. Rreziku i keqkuptimit të kësaj dispozite është vërtetë aktual, por mendojmë se edhe nga leximi i kujdesshëm i saj, i orientuar nga konceptet e drejta të së drejtës civile mund të kuptohet se nuk ka arsye të gjejë zbatim në rastin konkret. Kryerja e veprimeve që kapërcejnë administrimin e zakonshëm u takon bashkërisht të dy bashkëshortëve. Në rradhë të parë ky nen bën fjalë për anullimin

e veprimeve të bëra nga njëri prej bashkëshortëve. Termi anullim është i lidhur qartë me ato veprime që janë të anullueshme, pra veprimet juridike relativisht të pavlefshme. Përfundimisht, caktimi i një afati parashkrimi për ngritjen e kësaj padie, përjashton definitivisht mundësinë që të kemi të bëjmë me një veprim absoutisht të pavlefshëm, për shkak se kjo lloj pavlefshëmërie është e pashërueshme nga çdo afat kohor.

Kështu, tjetersimi i aksioneve të Shoqërisë "Top Channel" sh.a është kryer pa pëlqimin e të dy bashkëshortëve dhe për gjithë sa u tha më lart, ky veprim disponimi është nul dhe nuk ka prodhuar asnjë pasojë ligjore dhe për këtë shkak konsiderohet sikur nuk është kryer ndonjëherë dhe në përputhje me këtë, të drejtat e palëve quhet se nuk kanë ndryshuar ndonjëherë statusin juridik. Kjo do të thotë se kalimi i aksioneve nga i ndjeri Dritan Hoxha tek të paditurit Albert Sino dhe Aurel Baçi, nuk është kryer asnjëherë.

Kontrata e shitjes se aksioneve si një veprim juridik fiktiv, si shkak i pavlefshmerise. Në fakt kontrata e lidhur mes Dritan Hoxhës dhe të paditurve ka qenë një veprim fiktiv. Ajo është lidhur vetëm për të plotësuar për sy e faqe kriteret e nenit 20 të ligji Nr.9742, datë 08.05.2007, që kërkonte që asnjë subjekt në fushën e medias të mos zotërohej për më shumë se 40% nga një person i vetëm. Është për këtë shkak që Dritan Hoxha lidhi për sy e faqe një kontratë me dy të njohur të tij, siç ishin të paditurit.

Vlerësimi i fiktivitetit të kësaj marrëveshje është shumë i thjeshtë, pasi ai lidhet me caktimin dhe pagimin e çmimit të kontratës. Çmimi për të paditurin Albert Sino, për 40% të aksioneve, ishte 210,160,000 lekë dhe për të paditurin Aurel Baçi, për 20% të aksioneve, ishte 105,080,000 lekë. Këto çmime thuhet në kontratë se janë paguar jashtë zyrës së noterit, ndërkohë që nuk rezulton asnjëherë kryerja e kësaj pagese. Këto çmime ishin jo vetëm të pamundur për t'u paguar nga të paditurit, por edhe nëse do të ishin paguar ato nuk mund të vërtetohen me deftesë të thjeshtë, për shkak se në kuadër të ligjit, ato duhet të paguhen detyrimisht në rrugë formale bankare, për shkak të kufijve të caktuar me ligj. Kontrata e lidhur nuk mundet kurrsesi të zevendësojë apo të shëroje veset e pagesës informale, që nuk është kryer asnjëherë dhe që nuk ka patur qëllim të kryhej për shkak se palët kanë simuluar veprimin juridik.

Për këto arsye, pronarë të aksioneve të Shoqërisë "Top Channel" sh.a duhet të njihen trashëgimtarët e shitësit, sikurse janë caktuar në dëshminë e trashëgimisë së lëshuar për të ndjerin Dritan Hoxha, e konkretisht Vjollca Hoxha, Lorela Hoxha, Sara Hoxha, Redia Hoxha dhe Itan Hoxha. Duke qenë se paditësit e mësipërm, trashëgojnë të ndjerin Dritan Hoxha, në pjesë të barabarta, atëherë duhet të urdhërohet që secili prej paditësve të njihet si pronar i aksioneve të Shoqërisë "Top

Channel" sh.a në masën 20% secili.

Palët e paditura Albert Sino dhe Aurel Baçi prapësojnë përfundimisht se: Shitja e aksioneve është bazuar mbi vendimin e aksionarit të vetëm të Shoqërisë "Top Channel" Sh.a, deri në atë moment, te ndjerit Dritan Hoxha, i marrë prej tij në datën 13.06.2007. Vendimi i aksionarit të vetëm i datës 13.06.2007 dhe kontrata e shitjes së aksioneve e datës 15.06.2007, janë depozituar, në përputhje me përcaktimet e ligjit të kohës, në regjistrin tregtar, me anë të vendimit Nr.25561/8, datë 15.06.2007 të gjyqtarit të vetëm të seksionit tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Duke analizuar dispozitat ligjore, rezulton se padia është ngritur mbi një bazë ligjore të gabuar. Sipas bazës ligjore të padisë rezulton se pala paditëse i mbështet kërkimet e saj mbi bazën e neneve 199 dhe 208 të Kodit Civil, nene këto nuk rregullojnë pasurinë bashkëshortore si pjesë e bashkëpronësisë në tërësi, por japin rregullim për bashkepronësinë në pjesë.

Paditësja Vjollca Hoxha, me cilësinë e përfituesit të aksioneve si pasojë e trashëgimisë nga i ndjeri Dritan Hoxha, ka që nga viti 2008 me këtë cilësi në shoqëri, ajo ka qenë plotësisht në dijeni të faktit të pronësisë së aksioneve të të dy të paditurve Albert Sino dhe Aurel Baçi. Në këto kushte, ajo ka pasur dijeni për pronësinë e aksioneve nga dy të paditurit si edhe për origjinën e pronësisë së aksioneve të tyre.

Theksohet fakti se origjina e pronësisë së të paditurve mbi aksionet e Shoqërisë "Top Channel" Sh.a., është publike edhe nëpërmjet regjistrimit në regjistrin tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, të kontratës së shitblerjes së aksioneve me Nr.1154Rep., dhe Nr.598/2Kol., datë 15.06.2007, e lidhur përpara noterit Artan Treska, si edhe të vendimit të aksionarit të vetëm, që ka miratuar shitjen e këtyre aksioneve.

Në këto kushte, prezumohet se me anë të regjistrimit të kontratës së shitjes së aksioneve si edhe të vendimit të aksionarit, është kryer marrja dijeni e çdo personi për kryerjen e një akti të tillë. Në këto kushte, prezumohet edhe fakti se data e marrjes dijeni për shitjen e aksioneve, nëpërmjet kontratës së shitjes nga i ndjeri Dritan Hoxha tek të paditurit Albert Sino dhe Aurel Baçi, është data e regjistrimit ne regjistrin tregtar. Sa më sipër, rezulton se e drejta e padisë është parashkruar, pasi padia nuk është ngritur brenda afatit l-vjeçar, nga dita e marrjes dijeni. Pala paditëse ka njohur, pranuar dhe marrë vendime së bashku me të paditurit Albert Sino dhe Aurel Baçi, në jo më pak se 12 (dymbëdhjetë) raste, vendime të Mbledhjes së Aksionarëve dhe akte të tjera thelbësore për funksionimin e këtij subjekti tregtar në 6- 7 vite, si bashkëaksionarë në Shoqërinë "Top Channel" Sh.a.

Po kështu e drejta e ngritjes së padisë është parashkruar edhe për faktin

tjetër, që kjo padi nuk është ngritur brenda 1 viti nga data që bashkëpronësia ndërmjet bashkëshortëve ka përfunduar. Sipas germës "a" të nenit 96 të Kodit të Familjes është parashikuar se: "'bashkësia mbaron me vdekjen e njërit pret bashkëshortëve... ." .

Në rastin objekt gjykimi, rezulton e provuar se bashkësia midis bashkëshortëve Dritan dhe Vjolllca Hoxha ka mbaruar në datën 23.05.2008, datë në të cilën ka ndërruar jetë i ndjeri Dritan Hoxha. Ndërsa, në datën 06.06.2008 është vetë paditësja Vjollca Hoxha, e cila i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka vendosur të lëshojë dëshminë e trashëgimisë ligjore për të ndjerin. Ne këto kushte, edhe sikur t'i marrim të mirëqena pretendimet e ngritura nga pala paditëse, përsëri rezulton se kjo padi është ngritur jashtë afatit 1 (një) vjeçar të parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit 96 të Kodit të Familjes.

Në rastin objekt gjykimi, provohet dhe se shitja e aksioneve nga shitësi Dritan Hoxha tek blerësit Albert Sino dhe Aurel Baçi, është bërë kundrejt çmimit nominal të tyre, përkatësisht 210.160.000 lekë dhe 105.080.000 lekë. Aksionet nuk janë tjetërsuar me një çmim më të ulët se ai norninal dhe as nuk janë dhuruar në ndonjë mënyrë nga i ndjeri Dritan Hoxha, tek të paditurit në gjykim. Sipas legjislacionit të kohës, që ka qënë në fuqi në kohën e nënshkrimit të kontratës për shitjen e aksioneve, nuk ka pasur ndonjë dispozitë ligjore, e cila lidhte vlefshmërinë apo fiktivitetin e veprimeve juridike civile me mënyrën apo formën e kryerjes së pagesave. Ligji i kohës lejonte palët në qarkullimin civil, që pagesat për çfarëdo shume të kryheshin nëpërmjet palëve në çdo formë që ato binin dakord me njëra tjetren.

Nga ana tjetër kërkojmë të sqarojmë se, bashkësia ligjore dhe regjimi i saj vërtet cilësohet se përbëhet edhe nga "veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës", por nga ana tjetër, duhet që kjo veprimtari tregtare, të ekzistojë edhe në momentin e përfundimit të bashkësisë, pra në rastin objekt gjykimi, në momentin e ndërrimit jetë të bashkëshortit Dritan Hoxha dhe fitimit të cilësisë së trashëgimtarit nga paditësit në këtë gykim. Çka do të thotë që, nëse veprimtaria tregtare (apo pjesë e saj) nuk ekziston më si e tillë në emër të bashkëshortit që ka ndërruar jetë në momentin e përfundimit të bashkësisë, ajo nuk i nenshtrohet percaktimeve te nenit 74 te Kodit te Familjes.

Vleresimi i Gjykates se Apelit mbeshtetet ne aktet, dokumentat pretendimet e paleve paditese dhe paleve te paditura por edhe nga ankimi i paraqitur perpara kesaj Gjykate por edhe provat e administruara ne Gjykimin ne shkalle te Pare. Perpara se te jape nje konkluzion te qarte me natyren e konflikit dhe mosmarrveshjes duhet te sillet ne vemendje te gjykates te gjitha dispozitat ligjore qe kane te bejne me natyren e ceshtjes:

Në nenin 92 të Kodit Civil parashikohet se: "*Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që: a) vijnë në kundërshtim me*

një dispozitë urdhëruese të ligjit; b) kryhen për të mashtruar ligjin; c) kryhen nga të mitur nën moshën katërmbëdhjetë vjeç; ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa patur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluara)."

Në nenin 93 te këtij Kodi, parashikohet se: "*Kur veprimi juridik është bërë me qëllim për të mbuluar një veprim juridik tjetër, ky i fundit është i vlefshëm në qoftë se përmbush gjithë kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e tij. Veprimi juridik fiktiv ose i simuluar nuk dëmton personat e tretë të cilët në mirëbesim kanë fituar të drejta në bazë të tij.*"

Në vendimin unifikues Nr.932, datë 22.06.2000, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë unifikuar se: "*.....Në rastet e fiktivitetit dhe të simulimit mosperputhjen midis vullnetit dhe çfaqes së tij e duan vetë palët e veprimit juridik. Veprimi juridik është i simuluar kur kryhet me qëllim që të mbulojë një veprim tjetër juridik të vlefshëm apo të pavlefshëm, të cilin palët kanë dashur ta kryejnë me të vërtete dhe që rezulton prej kundërdeklarimit si marreveshje e fshehtë midis tyre.....*"

Pasojat e pavlefshmërisë së veprimit juridik janë parashikuar në nenin 106 të Kodit Civil, ku parashikohet se: "*Kur veprimi juridik është i pavlefshëm për arsye se vjen në kundërshtim me ligjin, ose është bërë me qëllim mashtrimi të ligjit, çdo gjë që palët i kanë dhënë njëra-tjetrës merret dhe kalon në të ardhurat e shtetit dhe kur nuk është e mundur të merret po ajo gjë, kërkohet vlefta e saj. Kur njëra nga palët ka vepruar në mirëbesim, gjykata mund të vendosë që çdo gjë që ka dhënë kjo palë t'i kthehet kësaj dhe kur nuk është e mundur kthimi i po kësaj gjëje, i paguhet vlefta e saj.*"

Sipas nenit 94 të Kodit Civil: "Të anulueshme quhen veprimet juridike të cilat janë të vlefshme gjersa gjykata me kërkesën e të interesuarit i shpall të pavlefshme... ."

Neni 20 i ligjit Nr.8794, datë 10.5.2001 "Për disa ndryshime në ligjin Nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin Nr.8655, datë 31.7.2000", në fuqi në kohën e nënshkrimit të kontratës, parashkon: "Liçencat janë dy llojesh: kombëtare dhe vendore. Liçencat për transmetim televiziv ose radioje në shkallë kombëtare u jepen shoqërive anonime që themelohen me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë me objekt ekskluziv veprimtarinë radiotelevizive. Aksionet që përfaqësojnë kapitalin në një shoqëri, mbajtëse të një liçence për transmetim televiziv ose radio, janë nominativë. Asnjë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, nuk duhet të ketë më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë... ."

Neni 20 i ligjit si më lart cituar, është zevendesuar nga neni 62 i ligjit aktualisht në fuqi, Nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e

Shqipërisë", i cili parashikon: "1. Licenca kombëtare e transmetimit audio dhe licenca kombëtare e transmetimit audioviziv u jepen vetëm shoqërive aksionare të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë si objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive. 2. Aksionet që përfaqësojnë kapitalin në një shoqëri, mbajtëse të një licence kombëtare për transmetim audio apo licencë kombëtare e transmetimit audioviziv, janë nominative. 3. Asnjë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, nuk mund të ketë më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë aksionare, që zotëron një licencë kombëtare për transmetimet audio ose një licencë komb ëtare të transmetimit audioviziv... ."

Në Pjesën II, Titulli III, Kreun e I të Kodit Civil, nenet 199 – 208, parashikohet bashkëpronësia në pjese. Sipas këtyre dispozitave: "Ka bashkëpronësi kur një ose disa sende dhe të drejta të tjera reale u përkasin bashkërisht dy ose më shumë personave... ." dhe në vijim neni 208 i Kodit, i cili parashikon se: "Tjetërsimi i sendit të përbashkët mund të bëhet vetëm me pëlqimin e të gjithë bashkëpronarëve."

Në Kreu II i Kodit Civil, në vijim, parashikohet: "A. Bashkëpronësia e detyrueshme; B. Bashkëpronësia midis anëtarëve të familjes bujqësore dhe C. Bashkëpronësia ndërmjet bashkëshortëve", per te cilen neni 231 i Kodit ka bere kete parashikim: "Bashkëpronësia ndërmjet bashkëshortëve rregullohet me dispozita të Kodit të Familjes."

Neni 66 i Kodit të Familjes parashikon regjimin pasuror martesor të bashkëshortëve: "Regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve rregullohet me ligj, në mungesë të marrëveshjes së veçantë, ku bashkëshortët parashikojnë regjimin që dëshirojnë, i cili nuk duhet të vijë në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi dhe legjislacionit përkatës."

Neni 314 i Kodit parashikon se: "Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë zbatohet për marrëdhëniet juridike të krijuara pas hyrjes në fuqi të tij." dhe në vijim neni 315 parashikon: "Bashkëpronësia e bashkëshortëve, e krijuar para hyrjes në fuqi të Kodit të Familjes, mund të ndryshojë me marrëveshje të bashkëshortëve, sipas dispozitave të këtij Kodi. Pasuria që fitohet nga bashkëshortët pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi, rregullohet nga ky Kod edhe për bashkëshortët që kanë lidhur martesë para hyrjes në fuqi të tij."

Në nenin 73 te Kodit te Familjes parashikohet - "Bashkësia ligjore" si: "Regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore zbatohet kur bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë për regjim tjetër pasuror martesor."

Neni 74 i Kodit parashikon përbërjen e bashkësisë: "Bashkësia përbëhet nga: a) pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, së bashku ose veç e veç, gjatë martesës; b) të ardhurat nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkëshorti gjatë martesës, nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë; c) frytet e pasurisë së çdo bashkëshorti, që janë marrë dhe nuk janë konsumuar deri në mbarimin e

bashkëpronësisë; ç)veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës. Në rast se veprimtaria tregtare para lidhjes së martesës i përkiste vetëm njërit prej bashkëshortëve, por gjatë martesës drejtohet nga të dy bashkëshortët, bashkësia përfshin vetëm fitimet dhe shtimin e prodhimit."

Në nenin 90 te Kodit te Familjes parashikohet administrimi i bashkësisë. Sipas kesaj dispozite: "Secili bashkëshort ka të drejtën e administrimit të zakonshëm të pasurisë në bashkësi. Secili bashkëshort është përfaqësues ligjor edhe i bashkëshortit tjetër përpara organeve administrative dhe gjyqësore për çështje që kanë të bëjnë me administrimin e zakonshëm të pasurisë në bashkësi. Kryerja e veprimeve që kapërcejnë administrimin e zakonshëm u takon bashkërisht të dy bashkëshortëve."

Në nenin 91 te Kodit parashikohet administrimi jo i zakonshëm nga njëri bashkëshort: "Në rast largësie ose pengese tjetër të njërit bashkëshort dhe në mungesë të prokurës ose autorizimit të gjykatës, bashkëshorti tjetër mund të kryejë veprimet që janë të nevojshme edhe në rastin kur kërkohet pëlqimi i të dy bashkëshortëve, sipas nenit 90 të këtij Kodi."

Neni 92 i Kodit parashikon refuzimin e pëlqimit: – "Nëse njëri prej bashkëshortëve refuzon të japë pëlqimin për kryerjen e një veprimi të administrimit të jashtëzakonshëm ose për veprime të tjera, për të cilat kërkohet pëlqimi, bashkëshorti tjetër mund t'i drejtohet gjykatës për të marrë autorizimin. Gjykata vendos dhënien e autorizimit kur kryerja e veprimit është e nevojshme për interesa të familjes ose të veprimtarisë tregtare që bën pjesë në bashkësi."

Ne nenin 93 te Kodit te Familjes parashikohet zëvendësimin në administrim: - Nëse njëri nga bashkëshortët, për një kohë të vazhdueshme, ndodhet jashtë gjendjes për të shprehur vullnetin e tij, ose nëse administrimi i bashkësisë nga ana e tij dëshmon për paaftësi ose keqbesim, bashkëshorti tjetër mund t'i kërkojë gjykatës të zëvendësojë atë në ushtrimin e të drejtave të tij. Bashkëshorti i privuar nga të drejtat e administrimit të bashkësisë mund t'i kërkojë gjykatës rikthimin e tyre, nëse provon se janë zhdukur shkaqet e përjashtimit të tij nga administrimi."

Neni 94 i Kodit parashikon tejkalimin e të drejtave nga njeri prej bashkeshorteve – "Nëse njëri nga bashkëshortët tejkalon të drejtat e tij mbi pasurinë në bashkësi, mund të kërkohet nga bashkëshorti tjetër anulimi i veprimit, nëse më vonë ai nuk ka dhënë pëlqimin për këtë veprim. Kjo padi mund të ngrihet brenda 1 viti nga data e marrjes dijeni për veprimin dhe, në çdo rast, jo më vonë se 1 vit nga mbarimi i bashkësisë."

Neni 96 i Kodit parashikon mbarimin e bashkësisë – "Bashkësia mbaron me: a) vdekjen e njërit prej bashkëshortëve, shpalljen i zhdukur ose i vdekur të njërit prej tyre, shpalljen të pavlefshme dhe zgjidhjen e martesës; b) pjesëtimin e pasurive; c) ndryshimin e regjimit pasuror martesor, kur sjell mbarimin e

bashkësisë."

Neni 112 i Kodit Civil parashikon se: "E drejta e padisë që nuk është ushtruar brenda afatit të caktuar në ligj, shuhet dhe nuk mund të realizohet më me anë të gjykatës ose të organit tjetër kompetent".

Neni 117 i Kodit Civil parashikon se: "Afati i parashkrimit fillon nga dita kur subjektit i ka lindur e drejta e padisë"

Gjykata e Apelit nisur nga analiza e faktit, pretendimeve dhe prapësimeve të palëve ndërgjyqëse dhe analizës së parashikimeve ne ligj, bazuar në nenin 16 të Kodit të Procedurës Civile dhe nën vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë Nr.3, datë 29.03.2012, Gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore, të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj, duke zgjidhur çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar.

Gjykata e Apelit cmon se tërësia e provave shkresore, të cilat iu nënshtruan hetimit gjyqësor, rezultoi e provuar se pala paditëse Vjollca Hoxha dhe i ndjeri Dritan Hoxha, kanë lidhur martesë ligjore më datë 17.08.1991, ndërsa, Shoqeria "Top Channel" sha është krijuar si një shoqëri anonime e së drejtës tregtare, me vendimin Nr.25561/6, date 08.03.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim me të cilin është vendosur depozitimi i vendimit datë 24.02.2006 të ortakut të vetëm, të ndjerit Dritan Hoxha, për shndërrimin e shoqërisë nga një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara (SHPK) në një shoqëri anonime (SHA).

Gjykata cmon se bazuar në nenet 314, 73 dhe 74 të Kodit te Familjes, në mungesë të një kontrate martesore midis bashkeshorteve Vjollca Hoxha dhe të ndjerit Dritan Hoxha, Gjykata çmon se marredheniet pasurore ndërmjet tyre, do t'i nënshtrohen regjimit pasuror të bashkësisë ligjore. Në nenin 74 gërma ç të Kodit të Familjes parashikohet si objekt i bashkësisë dhe veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës, e cila njihet në teorinë e së drejtës si bashkësi aktuale. Veprimtaria tregtare, sipas këtij neni, përfshin një listë joshteruese të formave me të cilat veprimtaria tregtare shfaqet në treg, që nga personi fizik, si subjekt i së drejtës tregtare, deri tek personat juridikë tregtarë.

Kjo dispozitë e Kodit te Familjes duhet të interpretohet në mënyrë të harmonizuar me legjislacionin që rregullon shoqeritë tregtare. Kështu, përsa i përket shoqërive tregtare, do të konsiderohen se bëjnë pjesë në bashkësinë ligjore, pjesëmarrjet e njërit bashkëshortit në kapitalin e shoqerisë, të fituar gjatë martesës, kur pjesët e fituara prej tij, nuk bazohen në cilësitë personale dhe nuk përfshijnë aktivitetin personal të tij në administrimin e shoqerisë.

Gjykata arrin në perfundimin se pjesëmarrjet në kapitalin e Shoqërisë "Top Channel" sha, të të ndjerit Dritan Hoxha, në cilësinë e zotëruesit të 100% të

aksioneve të saj, me natyrë nominative, bëjnë pjesë në bashkësinë ligjore të bashkëshortëve dhe si rrjedhoje do t'i nënshtrohet rregullimit ligjor sipas dispozitave te Kodit të Familjes të vitit 2003. Bashkësia ligjore ndërmjet bashkëshortëve përfaqëson një bashkëpronësi sui generis, e cila shoqërohet nga një regjim juridik i posaçëm. Pra, bashkësia ligjore përfaqeson një modalitet të së drejtës së pronës private që i perket personave fizike, e cila perbehet dhe nga te mirat e fituara, nga secili bashkëshort apo të dy së bashku, gjatë martesës, mbi te cilat ata kanë një të drejtë pronësie të pandarë, e drejte kjo që i jep mundësinë e ushtrimit të përbashkët të tagreve të posedimit, përdorimit dhe disponimit të këtyre sendeve apo të mirave.

Ne bazë të nenit 90 të Kodit të Familjes, rezulton se kryerja e veprimeve të administrimit të bashkësisë, i nënshtohen një rregullimi të ndryshëm, në varësi të llojit të administrimit, nëse ai është i zakonshëm apo i jashtëzakonshëm. Në lidhje me keto koncpte nuk ekzistojnë përkufizime po kritere ligjore, per të kategorizuar nëse një veprim administrimi cilësohet apo jo i zakonshëm. Megjithatë, sipas teorisë të së drejtës do të konsiderohen si veprime të administrimit të zakonshëm, çdo veprim nëpërmjet të cilit parandalohet zvogëlimi apo humbja e pasurisë, siç janë veprimet juridike që parandalojnë humbjen e një të drejte, veprimet juridike që realizojnë shfrytëzimin ekonomik të bashkësisë, disa veprime disponimi, veprimet juridike pakundërshpërblim etj.

Gjykata e Apelit cmon se ë disa raste përjashtimore, administrimi jo i zakonshëm mund të kryhet dhe pa pëlqimin e të dy bashkeshortëve, si: Kryerja e veprimeve te administrimit jo te zakonshem me pelqimin vetem te njerit bashkeshort, nese plotesohen ne menyre kumulative kushtet e nenit 91 te Kodit te Familjes; Autorizimi i Gjykatës për kryerjen e një veprimi administrimi jo të zakonshëm nga njëri bashkëshort, në kushtet e nenit 58 dhe nenit 92 te Kodit te Familjes. Zëvëndësimi në ushtrimin e te drejtave të administrimit jo të zakonshëm të njërit bashkëshort nga bashkëshorti tjetër, sipas nenit 59 dhe 93 te Kodit të Familjes.

Gjykata e Apelit cmon se kryerja e veprimeve të administrimit jo të zakonshëm nga njëri prej bashkëshortëve, pa pelqimin paraprak apo të mëvonshëm të bashkëshortit tjetër, ka si sanksion pavlefshmerinë relative të veprimit juridik të kryer. Ky disponim parashikohet shprehimisht në nenin 94 të Kodit të Familjes, sipas të cilit nëse njëri nga bashkëshortët tejkalon të drejtat e tij mbi pasurinë në bashkësi, mund të kërkohet nga bashkëshorti tjetër anulimi i veprimit, nëse më vonë ai nuk ka dhënë pëlqimin për këtë veprim. Nëse veprimi i administrimit jo të zakonshëm, siç është dhe tjetërsimi apo alienimi, kryhet nga njëri prej bashkeshortëve, bashkëshorti tjetër që nuk ka dhënë pëlqimin e tij, mund të vleftesojë veprimin, pra të japë pëlqimin e mëvonshem, ose të kërkojë gjyqësisht me padi anullimin e veprimit juridik, sipas rregullave që rregullojnë

pavlefshmerinë relative.

Gjykata e Apelit dhënia e pëlqimit të mëvonshëm për tjetërsimin nga ana e bashkëshortit të përjashtuar, i jep stabilitet përfundimtar apo siguri juridike, pasojave të një tjetërsimi të rregullt. Neni 94 i Kodit te Familjes synon të mbrojë arsyet që, bashkëshorti i përjashtuar nga dhenia e pelqimit, nuk ka mundur t'i shfaqë si kundershtime të mundshme në veprimet e kryera nga bashkëshorti tjetër. Pra, në rastin kur pas kryerjes së veprimit, bashkëshorti i përjashtuar tregon dhe pranon efektet juridike te kontratës së nënshkruar në mënyrë të veçuar nga bashkeshorti tjetër, nuk mund të mohojë një sjellje të tillë, në kuptimin e dhenies së pëlqimit. Duke u nisur nga specifika e marredhenies bashkëshortore, kërkimi i pavlefshmërisë relative ka natyre personale dhe si rrjedhoje mund te paraqitet si vetëm nga bashkëshorti i jashtëm në veprim, i cili mund te vlerësoje, a posteriori, leverdisshmerinë e veprimit dhe të vendose ngritjen e një padie.

Neni 94 i Kodit të Familjes përbën një parashikim jonormal, sipas të cilit një subjekt legjitimohet të kundërshtojë një kontratë të lidhur nga subjekte të tjera, të cilët janë bashkëshorti tjetër dhe i treti, që merr pjesë në veprim. Neni 94 disiplinon fatin e veprimeve të administrimit jo të zakonshëm, të kryera nga njeri prej bashkëshorteve pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër. Për ketë arsye, parashikohet një afat i limituar, brenda të cilit bashkëshorti i interesuar mund të kërkojë deklarimin e pavlefshem të aktit të kryer, pa pëlqimin e tij, sipas deklarimit te pavlefshëm të veprimeve juridike në përgjithësi.

Gjykata cmon se tjetërsimi i aksioneve nga ana e të ndjerit Dritan Hoxha, me kontratën e shitblerjes Nr.1154Rep., Nr.598Kol., datë 15.06.2007, në cilësinë e aksionerit të vetëm, tek blerësi, palë e paditur Albert Sino, dhe tek blerësi tjeter, i padituri Aurel Baçi, legjitimon palen paditëse Vjollca Hoxha, me cilesinë e bashkeshortes, per të kundërshtuar dhe kërkuar pavlefshmerinë e kesaj kontrate me anë të ngritjes së padisë, sipas nenit 94 të Kodit te Familjes dhe jo sipas nenit 92 dhe 208 te Kodit Civil. Koncepti i bashkësisë ligjore nuk mbivendoset me të drejtën e bashkëpronësisë mbi sendet e përbashkëta. Bashkësia ligjore është një tërësi të drejtash dhe detyrimesh, ku të drejtat formojnë aktivin e bashkësisë, ndërsa detyrimet pasivin e saj. Bashkësia ligjore është regjimi pasuror ndërmjet bashkëshortëve, i ndryshem nga bashkëpronesia e zakonshme, dhe për të cilën gjejnë zbatim vetëm dispozitat e Kodit të Familjes, si ligji i posaçëm që rregullon këto lloj marrëdheniesh juridike civile.

Gjykata e Apelit cmon meqenese pjesa e secilit bashkeshort eshte percaktuar per te kryer keto veprime disponimi apo veprime qe tejkalojne veprimet e admsnistrimit te zakonshem dhe te perditeshem, mbi nje send apo te drejte qe perfshihet nen bashkesine ligjore duhet te ekzistoje pelqimi i njekoheshem i te dy basheksh orteve per aq kohe sa ne momentin se lidhjes se kontrates se shitblerjeve

se aksioneve nuk ishte bere pjestimi i bashkesise ligjore, e drejta e pronesise se cdo bashkeshorti mbi pasurine ne bashkesi ekziston si nje e tere. Ne kushtet kur edhe veprimtaria tregtare përfshihet në pasurinë e përbashkët, duhet që sipas nenit 208 të Kodit Civil të japin pëlqimin të dy bashkëshortët, në përputhje edhe me nenin 90 të Kodit të Familjes dhe kjo dispozitë urdhëruese e ligjit dhe mosrespektimi i saj sjell pavlefshmëri absolute të veprimit të disponimit të pasurisë.

Gjykata cmon se duhet të gjejë aplikim afati i parashkrimit të nenit 94 i Kodit te Familjes. Pasi gjithmone ekziston rreziku i keqkuptimit të kësaj dispozite është vërtetë aktual, nuk ka arsye të gjejë zbatim në rastin konkret. Kryerja e veprimeve që kapërcejnë administrimin e zakonshëm u takon bashkërisht të dy bashkëshortëve. Kjo dispozite ligjore bën fjalë për anullimin e veprimeve të bëra nga njëri prej bashkëshortëve. Termi anullim është i lidhur qartë me ato veprime që janë të anullueshme, pra veprimet juridike relativisht të pavlefshme. Përfundimisht, caktimi i një afati parashkrimi për ngritjen e kësaj padie, përjashton definitivisht mundësinë që të kemi të bëjmë me një veprim absoutisht të pavlefshëm, për shkak se kjo lloj pavlefshëmërie është e pashërueshme nga çdo afat kohor.

Nga shqyrtimi teresor i provave rezulton se tjetersimi i aksioneve të Shoqërisë "Top Channel" sh.a është kryer pa pëlqimin e të dy bashkëshortëve dhe për gjithë sa u tha më lart, ky veprim disponimi është nul dhe nuk ka prodhuar asnjë pasojë ligjore dhe për këtë shkak konsiderohet sikur nuk është kryer ndonjëherë, dhe të drejtat e palëve duhet te konsiderohen se nuk kanë ndryshuar ndonjëherë statusin juridik. Ky arsyetim e con Gjykaten ne konkluzionin se ky veprim i kalimit te aksioneve nga i ndjeri Dritan Hoxha tek të paditurit Albert Sino dhe Aurel Baçi, duhet konsideruar qe nuk ka ndodhur asnjëherë. Kjo edhe per vete faktin se palet e paditur nuk ka sjelle asnje prove te qenesishme qe te vertetojne gjithashtu qe kane qene dhe zoteriesisht faktik dhe realisht te ketyre aksioneve edhe ne momentin aktual.

Gjykata e Apelit cmon se kontrata e shitjes se aksioneve te paleve ne konflikt eshte një veprim juridik fiktiv, si shkak i pavlefshmerise. Në fakt kontrata e lidhur mes Dritan Hoxhës dhe të paditurve ka qenë një veprim fiktiv. Gjykata cmon se kontrata eshte perpiluar dhe është lidhur vetëm për të plotësuar për sy e faqe kriteret e nenit 20 të ligji Nr.9742, datë 08.05.2007, që kërkonte që asnjë subjekt në fushën e medias të mos zotërohej për më shumë se 40% nga një person i vetëm. Është për këtë shkak që Dritan Hoxha lidhi për sy e faqe një kontratë me dy të njohur të tij, siç ishin të paditurit. Kjo per faktin se kjo kontrate eshte bere pikerisht ne momentin e daljes se ligjit dhe nuk eshte bere perpara cka tregon me se miri dhe qellimin e vertete te perpilimit te kesaj kontrate nga ana e paleve qe eshte me veprime stimuluese dhe fiktive

Gjykata e Apelit cmon se nje elemet tjeter qe ben te pavlefshem veprimin

juridik te paleve dhe fiktivitetin e kësaj marrëveshje është shumë i thjeshtë, pasi ai lidhet me caktimin dhe pagimin e çmimit të kontratës. Çmimi për të paditurin Albert Sino, për 40% të aksioneve, ishte 210,160,000 lekë dhe për të paditurin Aurel Baçi, për 20% të aksioneve, ishte 105,080,000 lekë. Qe ne vlere te perafert jane rreth 3 miljon dollare. Sipas kontrates objekt gjykimi këto çmime thuhet në kontratë se janë paguar jashtë zyrës së noterit, ndërkohë që nuk rezulton asnjëherë kryerja e kësaj pagese. Nga shqyrtimi i akteve te dosjes rezulton se këto çmime ishin jo vetëm të pamundur për t'u paguar nga të paditurit, por edhe nëse do të ishin paguar ato nuk mund të vërtetohen me deftesë të thjeshtë, për shkak se në kuadër të ligjit "Per qarkullimin e vlerave monetare", ato duhet të paguhen detyrimisht në rrugë formale bankare, por edhe për shkak të kufijve të caktuar me ligj "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" qe ka qene ne fuqi ne kohen e kryerjes se veprimeve. Po keshtu kalimi i nje shume te tille Cash duhet te ishte dhe objekt i vleresimit te Drejtorise per Parandalimit e Pastrimit te Parave, kjo edhe ne kuader te edhe te Luftes kunder Terrorizmit. Gjate shqyrtimit gjyqesor i eshte kerkuar qe te provojne burimin e financiar te ketyre parave qe pretendohet qe jane paguar ne favor te pales tjeter jashte qarkullimit bankar por nuk kane dhene asnje detaj per aktivite apo bisnese qe kane disponuar ne ate kohe.

Gjykata mbi bazen e pyetjeve te realizuar jane hetimit gjyqesor kerkoj nga palet e paditura te paraqiste aktivitet e mundeshme financiare apo kontrata huaje apo kredi bankare qe ishin marre pikerisht ne kete periudhe vitin 2007 pra para lidhjes se kesaj kontrate qe te krijonte bindjen qe verimi juridik te jete kryer dhe nuk ishte fiktiv. Nga ana e pales paditur as ne Gjykaten e Shkalles se Pare por as ne Gjykaten e Apelit nuk kane sjelle asnje dokumet te ndonje aktiviteti tregtar te realizuar deri ne ate periudhe apo kontrata huaje me persona te trete apo kredi bankare te marra cka rrezon katerciperisht faktin se eshte realizuar ndonje pagese ne shuma te tilla ne vlere 3 miljon dollare jashte zyres se noterise. Kjo krijon bindjen per Gjykaten e Apelit se veprimi juridik eshte veprim fiktiv me efekte stimuluese ne menyre qe aksionet e shoqerise te mbeteshin 100% te dore te ortakut te vetem te asaj kompanie te ndjerit Dritan Hoxha. Kontrata e lidhur nuk mundet kurrsesi të zevendësojë apo të shëroje veset e pagesës informale, që nuk është kryer asnjëherë dhe që nuk ka patur qëllim të kryhej për shkak se palët kanë simuluar veprimin juridik. Po keshtu vendimi Nr.932, date 22.06.2000, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë unifikuar së në rastet e fiktivitetit dhe të simulimit, mosperputhjen midis vullnetit dhe shfaqjes së tij, e duan vetë palët e veprimit juridik. Veprimi juridik është i simuluar kur kryhet me qellim që të mbulojë një veprim tjetër juridik të vlefshëm apo të pavlefshëm, të cilin palët kanë dashur t'a kryejnë me të vërtetë.

Gjykata e Apelit nisur nga analiza e mesiperme por mbeshtetur ne te gjitha provat e administruar, pretendimet e paleve ne proces por nisur dhe ankimi i realizuar dhe duke patur parasyesh referencat ligjore qe palet perdorin per zgjidhjen e mosmarrevjeshjes por interpretimin e ndryshem te tyre dhe bazuar në tërësinë e provave shkresore, sjellja e palëve të paditura Albert Sino dhe Aurel Baçi, në cilësinë e aksionerëve të Shoqërisë "Top Channel" sha, në ushtrimin e tagrave të posedimit dhe të administrimit të aksioneve në shoqëri, pas lidhjes së kontratës noteriale Nr.1154Rep., Nr.598Kol., datë 15.06.2007, krijoi bindjen te ndryshme nga Gjykata e Shkalles se Pare Tirane se kontrata në fjalë ka qënë fiktive, pra sa per sy e faqe thjesht per te shmangur efektet e nenit 20 të ligji Nr.9742, datë 08.05.2007, qe asnjeri nga aksioneret te mos kishte me shume se 40% te aksioneve duke e bere kete kontrate te pavlefshme ne kuptim te nenit 92 te K.Civil dhe duke njohur si pronare te vetem te te gjithe aksioneve te shoqerise "Top Chanel" paditesat. Gjykata cmon se duhet te udherohet dhe ç'regjistrimi nga regjistri i aksioneve te Shoqerise "Top Channel"sh.a nga te paditurit Albert Sino dhe Aurel Baçi dhe nga regjistri i ekstraktit te Shoqerise ne Qendren Kombetare te Bisnezit, pasi ne baze te te cilit eshte bere regjistrimi i tyre ne regjister eshte i pavlefshem.

Ne keto rrethana Gjykata e Apelit e çmon te bazuar vendimin e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, duhet te ndryshohet dhe padia e paditesave duhet te pranohet, pasi pala e paditese para gjykates kane provuar ekzistencen e rrethanave dhe fakteve te cilat jane ngritur ne ankim per te krijuar bindjen qe vendimi duhet te te ndryshohet.

Nisur nga analiza e rrethanave te mesiperme ankimet e bera ne Gjykaten e Apelit si mjete mbrojtese ndaj vendimit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane gjenden te pabazuardhe te mbeshtetur ne prova dhe ne ligj, ndaj dhe vendimi i kesaj gjykate duhet te ndryshohet dhe padia e pales paditese duhet te pranohet ne teresi si e mbeshtetur ne prova dhe ne ligj.

PER KETO ARSYE

Gjykata e Apelit Tirane, bazuar ne nenin 466/b te K.Pr. Civile,

VENDOSI

Ndryshimin e vendimit nr .3873 date 09.05.2016 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane ne kete menyre:

1.Detyrimin e paleve te paditura Albert Sino dhe Aurel Baçi te njohin pronar paditesat Vjollca Hoxha, Lorela Hoxha, Sara Hoxha, Redia Hoxha dhe Itan Hoxha pronar edhe mbi 60% te aksioneve te Shoqerise "Top Channel" sh.a me Nipt K120070024, per shkak se kontrata e shitjes se aksioneve me nr.1154 Rep dhe Kol date 15.06.2007 eshte absolutisht e pavlefshme pasi eshte kryer ne kundershtim me ligjin.

2.Urdherohet ç'regjistrimi nga regjistri i aksioneve te Shoqerise "Top Channel"sh.a nga te paditurit Albert Sino dhe Aurel Baçi dhe nga regjistri i ekstraktit te Shoqerise ne Qendren Kombetare te Bisnezit, pasi ne baze te te cilit eshte bere regjistrimi i tyre ne regjister eshte i pavlefshem.

Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te paleve te paditura.

Bashkelidhur ketij vendimi leshohet urdheri i ekzekutimit.

U shpall ne Tirane, sot me dt.28.06.2017

ANETAR	ANETAR	KRYESUES
RIDVAN HADO	GJIN GJONI	HYSNI DEMIRAJ
dv	dv	dv

Vertetohet njesia me origjinalin
Kancelar
Lertida Balili

PULLE TARIFE 200 LEKE REPUBLIKA E SHQIPERISE